



©Copyright Kushtrim Tërnav



MOS MË MBYLL DERËN, JAM VETËM NJË FËMIJË!

Analizë mbi mbrojtjen e fëmijëve në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin dhe fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale (nën 14 vjeç)

Janar 2015

Autor:
Armen Mustafa, PhD C.

Ky publikim nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimet e donatorëve dhe partnerëve të KOMF.
Ky publikim nuk mund të shitet ose të përdoret për qëllime përfitimi.

Foto: Kushtrim Tërnavë

Rruga: Zenel Salihu
Ob.1, Hy.1, K.3, Nr.16, 10000
Prishtinë, Kosovë
info@komfkosova.org
www.komfkosova.org
Facebook: KOMF
Twitter: @komfkosova

MOS MË MBYLL DERËN, JAM VETËM NJË FËMIJË!

**ANALIZË MBI MBROJTJEN E FËMIJËVE NË RREZIK PËR TË RËNË NË
KONFLIKT ME LIGJIN DHE FËMIJËVE NË KONFLIKT ME LIGJIN PA
PËRGJEGJËSI PENALE (NËN 14 VJEÇ)**

Janar 2015, Prishtinë





Falenderime

Në emër të misionit të përbashkët për mbrojtjen, respektimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF, falenderon të gjithë ata që kontribuan në hartimin e kësaj analize, që ka qëllimin të kontribuojë në avancimin e mbrojtjes së fëmijëve në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin dhe fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale (nën 14 vjeç) në Kosovë.

Falenderim të veçantë KOMF shpreh për të gjithë ata që u përfshinë në këtë analizë:

- Qendrat për Punë Sociale në Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Ferizaj;
- Policinë e Kosovës në Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Ferizaj;
- Drejtoritë Komunale të Arsimit në Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Ferizaj;
- Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjes;
- Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Organizatat jo-qeveritare

Në veçanti falenderojmë të gjithë fëmijët dhe familjet e tyre që pranuan të ndajnë përvojën dhe përjetimet e tyre për këtë analizë.

Falenderojmë po ashtu Save the Children dhe UNICEF-in në Kosovë për përkrahjen në realizimin e saj.

Një falenderim i veçantë shkon për hartuesin e analizës z. Armen Mustafa dhe për grupin punues të KOMF.

Me respekt,
Blerta Perolli Shehu
Presidente
Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

Shkurtesat

DKA	Drejtorati Komunal i Arsimit
DKSHMS	Drejtorati Komunal i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
KD	Këshilli Drejtues
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KDM	Kodi i Drejtësisë për të Mitur
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
LAP	Ligji për Arsim Parauniversitar
LSHSF	Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OK	Organi i Kujdestarisë
PIA	Plani Individual i Arsimit
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
QPS	Qendra për Punë Sociale
UA	Udhëzim Administrativ
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

Përmbledhje Ekzekutive

Analiza për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin dhe fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale (nën 14 vjeç), vjen si rezultat i dukurisë në rritje të sjelljeve të fëmijëve në kundërshtim me rregullat dhe normat e përcaktuara shoqërore.

Qëllimi kryesor i kësaj analize është ofrimi i një pasqyre të situatës dhe kuadrit ligjor, boshllëqet dhe sfidat në zbatimin e tij në fushën e parandalimit, mbrojtjes dhe të ri-integrimit të fëmijëve që janë në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin apo fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale.

Gjatë procesit të hartimit të analizës, është analizuar në tërësi legjislacioni primar dhe sekondar në lidhje me fëmijët që janë në rrezik dhe në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale. Përpos kësaj, janë intervistuar për të marrë pikëpamjet e tyre edhe akterë të ndryshëm nga institucione të cilat kanë për mandat mbrojtjen e fëmijëve. Këto intervista janë zhvilluar me Qendrat për Punë Sociale, Policinë e Kosovës, Drejtoritë Komunale të Arsimit, me OJQ-të në katër qendra kryesore, si: Prishtina, Peja, Prizreni dhe Ferizaj. Analiza ka marrë në konsideratë edhe pikëpamjet e vet personave që janë subjekt i kësaj analize, duke intervistuar edhe fëmijët në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin, fëmijët që janë në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale dhe prindërit e tyre.

Të gjeturat tregojnë se ka dispozita ligjore që mundësojnë trajtimin dhe mbrojtjen e fëmijëve pa përgjegjësi penale, që kanë kryer vepra penale, ose që janë në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin. Megjithatë, kuadri ligjor aktual, nuk përcakton shërbime të veçanta karakteristike, përpos atyre që në përgjithësi ofrohen për kategori të ndryshme që janë në nevojë sociale, sikur që edhe nuk bënë përgjegjës në mënyrë eksplicite ndonjë institucion për të punuar në parandalimin e kësaj dukurie. Këshillimi individual dhe ai familjar është shërbimi kryesor që ofrohet (si në QPS, ashtu edhe në shkolla, aty ku ka psikologë).

Praktika tregon se këto shërbime janë të pamjaftueshme dhe shpesh jo efektive në parandalimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin e fëmijëve që janë në rrezik apo në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale. Kjo për faktin se rastet shpesh përsëriten, ato mbesin të hapura për kohë të gjatë dhe në fund kalojnë moshën e përgjegjësisë penale (14 vjeç), kur fillojnë përsëri të trajtohen nga organet e drejtësisë dhe rendit.

Gjithashtu, të gjeturat nga analiza tregojnë se ka një numër relativisht të vogël të rasteve të referuara në QPS, sidomos nga shkollat. Policia është institucioni i cili i referon shumicën e rasteve në QPS. Kurse nga institucionet e tjera (shëndetësore, etj), prindërit dhe komuniteti në përgjithësi, ka një numër simbolik të rasteve të referuara në QPS. Kjo nënkupton se komuniteti dhe institucionet që kanë për mandat mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal, nuk janë të familjarizuara sa duhet me legjislacionin në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në përgjithësi, po ashtu nuk njohin legjislacionin nga fusha tjetër, e shpesh edhe legjislacionin e fushës përkatëse. As në shkolla situata nuk është më e mirë. Shumica e shkollave kanë mungesë të psikologëve dhe shërbimeve profesionale. Përveç kësaj, shumica e mekanizmave të krijuar në shkolla (Këshilli Drejtues, Këshilli i Nxënësve, Këshilli i Prindërve), Kodet e Mirësjelljes dhe Rregulloret e brendshme të shkollave, të cilat ose nuk ekzistojnë, ose kur ekzistojnë, nuk janë funksionale. Kjo bënë që bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin të mos jetë në nivel dhe rrjedhimisht të mos shfrytëzohen edhe kapacitetet e tyre në drejtim të parandalimit, mbrojtjes dhe ri-integrimit të fëmijëve.



Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik apo në konflikt me ligjin, nuk është në nivel të duhur. Ka një reagim të tyre kur rasti ndodh, sidomos kur ai tejkalon përmasat e një institucioni (raste më të rënda), por bashkëpunimi, komunikimi dhe llogaridhënia është në nivel të ulët kur kemi të bëjmë me aktivitete që kanë qëllim parandalimin dhe ri-integrimin e fëmijëve.

Metodologjia

Në përputhje me Udhëzimet Metodologjike, janë përdorur metodat kërkimore siç vijojnë:

- a. Analiza e legjislacionit;
- b. Analiza e dokumenteve dhe literaturës relevante;
- c. Intervistat gjysmë të strukturuar me përfaqësues të institucioneve, fëmijët, prindërit dhe shoqërinë civile.

Realizimi i pyetësorëve

- Intervistat janë kryer me përfaqësues të institucioneve, të mandatuara për mbrojtjen e fëmijëve që janë në rrezik apo në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale, me fëmijë që janë në rrezik apo në konflikt me ligjin dhe prindërit e tyre, si dhe me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare që merren me fëmijë - 2;
- Fëmijë në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale - 3;
- Prindërit e fëmijëve që janë në rrezik apo në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale - 4;
- Zyrtarë të shërbimeve sociale dhe familjare të QPS - 8;
- Policë në Komunitet - 4;
- Zyrtarë të Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) - 4;
- Zyrtar të UNICEF-it - 1;
- OJQ "Terre des hommes" - 1;
- OJQ "Syri i Vizionit" - 1.

Mbulimi gjeografik

- Intervistat janë realizuar në katër komuna të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Prizren dhe Ferizaj.





Kapitulli 1

Legjislacioni

Fëmijët janë pjesë specifike dhe shumë e ndjeshme e shoqërisë, andaj iu kushtohet një vëmendje e veçantë mbrojtjes së të drejtave të tyre, si në aspektin ndërkombëtar, e po ashtu edhe në legjislacionin vendor të çdo vendi.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës - KDF

Në aspektin e instrumenteve ndërkombëtare është Konventa për të Drejtat e Fëmijës (më tutje KDF), si një dokument themelor që përcakton dhe mbron të drejtat e fëmijëve në përgjithësi. Sipas saj, “me termin fëmijë nënkuptohet çdo person nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur sipas legjislacionit përkatës mosha madhore arrihet më herët”¹.

Andaj, duke qenë se praktika jetësore has në shumë raste, kur fëmijët me sjelljen e tyre mund të jenë në kundërshtim me ligjin, ose janë në rrezik për një gjë të tillë, KDF përpos që ka përcaktuar se kush konsiderohet fëmijë, ajo ka përcaktuar dispozita të veçanta për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që bien në konflikt me ligjin², duke kërkuar nga shtetet palë të “përcaktojnë një moshë minimale, nën të cilën fëmijët konsiderohen të paafte për ta shkelur ligjin penal”³. Megjithatë, “fillimi i kësaj moshe nuk duhet të caktohet në një shkallë tejet të ulët, duke i marrë parasysh faktet e maturisë emocionale, mendore dhe intelektuale”⁴. Kjo dispozitë, sikurse edhe shumë dispozita dhe procedura të tjera, që përcaktojnë dhe qartësojnë të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin, mbrojtjen e tyre, hasen në shumë dokumente të tjera ndërkombëtare, të cilat kanë derivuar pikërisht nga KDF.

Kodi për drejtësi për të mitur

Në aspektin e legjislacionit vendor, duke qenë se objekt i trajtimit të kësaj analize janë fëmijët pa përgjegjësi penale në konflikt me ligjin dhe ata që me sjelljen e tyre janë në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin, janë disa ligje bazike, por edhe udhëzime administrative dhe akte tjera nënligjore që rregullojnë punën me fëmijët pa përgjegjësi penale në kundërshtim me ligjin, ose ata që janë në rrezik për një gjë të tillë, procedurat dhe shërbimet që iu ofrohen atyre. Kurse disa të tjera do të trajtohen këtu, në kuptim të mundësisë që ofrojnë për parandalimin e kësaj dukurie.

Të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtja e tyre, janë kategori kushtetuese, e përcaktuar me nenin 50 të Kushtetutës së Kosovës. Më tutje, këto të drejta rregullohen me ligje të veçanta dhe akte nënligjore, në varësi të fushës që i përkasin të drejtat e fëmijëve. Në bazë të legjislacionit penal në Kosovë, përkatësisht në Kodin Penal, mosha e përgjegjësisë penale është e përcaktuar në katërbëdhjetë (14) vjeç⁵. Për më tepër, kjo çështje rregullohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur (më tutje KDM), sipas të cilit:

“1. Për fëmijën nën moshën katërbëdhjetë (14) vjeç nuk fillon procedura gjyqësore. Nëse fëmija është nën moshën katërbëdhjetë (14) vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale, çdo procedurë gjyqësore që ka filluar pushohet menjëherë dhe Organi i Kujdestarisë njoftohet për rastin nga prokurori”.

¹ Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 1

² Konventa për të Drejtat e Fëmijës, nenet 37 dhe 40

³ Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 40 (3) (a)

⁴ Rregullat e Pekinit, rreg.1.1 deri 1.3

⁵ Kodi Penal i Kosovës, nr. 04/L-082, neni 17 (3)

"2. Organi i Kujdestarisë ndërmerr veprimet e caktuara në pajtim me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare për trajtimin e kryerësve të veprave penale nën moshën katëmbëdhjetë (14) vjeç në bazë të programeve të tij. Kjo çështje më hollësisht mund të rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale"⁶.

Pra, duke qenë se këta fëmijë janë nën moshën e përgjegjësisë penale (nën 14 vjeç) dhe Organi i Kujdestarisë (më tutje OK)⁷ është institucioni përgjegjës për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve, atëherë puna e OK rregullohet duke u bazuar në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare (më tutje LSHSF), si dhe në një akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (më tutje MPMS). Në këtë drejtim LSHSF, në lidhje me fëmijët pa përgjegjësi penale që janë nën moshën 14 vjeç njih:

- Fëmijët kryerës të veprave penale, pa përgjegjësi penale dhe
- Fëmijët me sjellje asociale⁸

Legjislacioni në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare

Përkufizimin më të saktë të këtyre nocioneve e gjejmë në Udhëzimin Administrativ nr.08/2013 për Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale pa Përgjegjësi Penale dhe të atyre me Sjellje Asociale, të cilin e ka nxjerr MPMS. Sipas këtij UA kemi:

"Fëmijë pa përgjegjësi penale konsiderohet çdo fëmijë nën moshën 14 vjeç, i cili ka kryer vepër penale dhe për shkak të moshës, ndaj tij nuk mund zhvillohet procedurë gjyqësore, e nëse procedura ka filluar, ajo pushon".

"Fëmijë me sjellje asociale konsiderohet çdo fëmijë i cili me sjelljen e tij bie në kundërshtim me normat pozitive, por që nuk kanë elemente të veprës së kundërvajtjes dhe veprës penale".

"Sjellje asociale konsiderohen shkeljet e përsëritura të rregullave sociale, në kundërshtim me rregullat e autoritetit, veprimet agresive ndaj moshatarëve, familjarëve, mësuesve dhe anëtarëve të komunitetit në përgjithësi, vjedhjet e gjërave të imta, pirja e duhanit dhe alkoolit, grindja brenda familjes, ikja nga shtëpia, ikja nga shkolla, bredhja, kategori e paspecifikuar, etj"⁹.

Ajo që bie në sy në dispozitat e LSHSF dhe në UA, nr. 08/2013 që ka nxjerr MPMS, përveç përkufizimeve të nocioneve që hasen në këtë UA dispozitat e tjera të këtij UA, janë përsëritje e dispozitave që janë paraparë për fëmijët pa përgjegjësi penale në LSHSF. Në fakt dispozitat e këtyre dy dokumenteve (ashtu si edhe KDM) përcaktojnë se organ përgjegjës për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve që kanë kryer vepra penale pa përgjegjësi penale dhe të atyre me sjellje asociale është OK. Ky organ me qëllim të mbrojtjes dhe trajtimin më të mirë të fëmijëve bashkëpunon edhe me organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare, institucionet shkollore, shëndetësore, policore, me familjen dhe komunitetin. OK në rastet kur kemi të bëjmë me fëmijë që kanë kryer vepra penale pa përgjegjësi

6 Kodi i Drejtësisë për të Mitur, nr. 03/L-193, neni 41 (1) dhe 41 (2)

7 Organi i Kujdestarisë është organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale. Ligji për Plotësim dhe Ndryshim i Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, nr.04/L-81, neni 1.7

8 Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, nr.02/L-17, neni 11.A dhe 11.B (Ligji për plotësim dhe ndryshim nr.04/L-081, neni 11)

9 MPMS, UA, nr.08/2013 për Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale pa Përgjegjësi Penale dhe të atyre me Sjellje Asociale, neni 3

penale, njoftohet nga Prokurori, kurse në rastet kur kemi të bëjmë me fëmijë me sjellje asociale, rastet në OK pra në Qendër për Punë Sociale (më tutje QPS), referohen nga familja, shkolla, komuniteti, institucioni shëndetësor, shërbimi sprovues, policia, OJQ-të, etj. Në momentet kur këto raste referohen në QPS, atëherë në këtë institucion caktohet menaxheri i rastit¹⁰ për çdo rast të referuar. Ky menaxher, me tutje harton planin e mbrojtjes dhe krijon ekipin për mbrojtje dhe trajtim¹¹.

Shërbimet të cilat mund t'u ofrohen fëmijëve që kanë kryer vepra penale pa përgjegjësi penale dhe atyre me sjellje asociale janë të rregulluar me LSHSF, sipas të cilit ligj, personave në nevojë mund t'u ofrohen shërbimet sociale dhe familjare si: ofrimi i drejtpërdrejtë i përkujdesjes sociale, këshillimit ose në raste të veçanta, ndihmë materiale për njerëzit në nevojë sociale¹².

Ajo që vlen të theksohet në aspektin pozitiv në lidhje me dispozitat ligjore në LSHSF është fakti se mbrojtja dhe trajtimi i fëmijës në rrezik apo konflikt me ligjin synohet të bëhet në sistem, duke e shikuar sjelljen e fëmijës si rezultat i asaj që ndodh në rrethin e tij shoqëror dhe duke i trajtuar këto probleme bashkë me rrethin e tij (prindër, familja, shkolla, institucione tjera, komunitet, etj).

Një anë tjetër pozitive, e LSHSF-së, por edhe në UA, nr.08/2013 të nxjerrë nga MPMS, ka të bëjë me qasjen parandaluese që ka ky ligj në lidhje me fëmijët pa përgjegjësi penale. Kjo vlen sidomos me dispozitat që kanë të bëjnë me "fëmijët me sjellje asociale", që në fakt janë fëmijë që janë në rrezik që në të ardhmen e afërt sjellja e tyre të jetë në kundërshtim me ligjin. Shërbimet që marrin fëmijët, kanë pikërisht për qëllim që të parandalojnë që fëmijët në kohën kur kanë një zhvillim të hovshëm psiko-fizik dhe social, kur ndryshimi është ende shumë i mundshëm, më i lehtë dhe shumë më i shpejtë.

Përkundër anës pozitive të këtyre dispozitave në LSHSF, megjithatë aktivizimi i QPS sipas këtyre dispozitave në këto raste bëhet vetëm atëherë kur sjellja në kundërshtim me ligjin apo me normat shoqërore ka ndodhur.

Gjithashtu, zbatimi i këtyre dispozitave në masë të madhe varet nga bashkëpunimi që QPS ka me institucione qeveritare dhe jo-qeveritare, e sidomos me shkolla, policinë, familje dhe komunitetin. Kjo, sepse referimi i rasteve të fëmijëve me sjellje asociale në QPS varet prej tyre. Nga kjo nënkuptohet se QPS nuk ka ndonjë mandat që në bashkëpunim me institucione tjera të punojë edhe në identifikimin e hershëm të fëmijëve që janë në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin.

Legjislacioni në fushën e Policisë

Ligji për Policinë nr. 04/L-076, nuk ka ndonjë dispozitë që trajton çështjen e fëmijëve pa përgjegjësi penale që janë në kundërshtim me ligjin, ose ata që janë në rrezik për një gjë të tillë. Megjithatë janë Procedurat Standarde të Operimit (më tutje PSO) DDO – 04/041/2013, "Qasja Policore ndaj Rasteve me Persona të Mitur" që parasheh të gjitha përgjegjësitë dhe procedurat e punës së PK-së me fëmijët në përgjithësi, e në rastin konkret edhe për fëmijët që kanë rënë në kundërshtim me ligjin ose me sjellje asociale, por që janë nën moshën 14 vjeç.

¹⁰ Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, nr.02/L-17, neni 11.A dhe 11.B (Ligji për plotësim dhe ndryshim nr.04/L-081, neni 11)

¹¹ MPMS, UA, nr.08/2013 për Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale pa Përgjegjësi Penale dhe të atyre me Sjellje Asociale, neni 4.1

¹² Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, nr.02/L-17, neni 1.3

Sipas dispozitave në këtë PSO, për të gjitha rastet që kanë të bëjnë me fëmijët me sjellje asociale, PK duhet t'a njoftojë prindin dhe QPS-në¹³. Kurse, në rastet kur dyshohet se fëmijët kanë kryer vepra penale e që janë nën moshën e përgjegjësisë penale, përpos prindit dhe QPS-së, ata njoftojnë edhe Prokurorin, por pa ushtruar kallëzim penal¹⁴.

Për më tepër, PK në bazë të kësaj PSO është e obliguar të punojë edhe në parandalimin e sjelljeve asociale, duke hartuar plane gjithëpërfshirëse të parandalimit, duke implementuar projekte në shkolla në bashkëpunim me institucione të ndryshme dhe OJQ, me qëllim të vetëdijesimit të rinjve dhe parandalimin e dukurive negative në shoqëri¹⁵.

Legjislacioni në fushën e arsimit

Sidoqoftë, nëse marrim parasysh se moshën e fëmijëve është nën 14 vjeç, atëherë rezultojnë se kemi të bëjmë me fëmijë të moshës shkollore, përkatësisht në kushte normale për nxënës të shkollave 9 vjeçare. Kjo nënkupton se shkolla si institucion edukativo-arsimor është institucion që ka përgjegjësi primare, sidomos në parandalimin e sjelljeve asociale, për të cilat fëmijët rrezikojnë të jenë në kundërshtim me ligjin ose edhe të bëjnë vepra penale. Megjithatë, nëse i referohemi Ligjit bazik që rregullon fushën e arsimit në nivelin e arsimit parauniversitar, pra Ligjit për Arsim Parauniversitar në Kosovë, nr. 04/L-032 (më tutje LAP), shohim se nuk ka ndonjë dispozitë që trajton drejtpërdrejtë problemet e sjelljeve dhe të dukurive negative të fëmijëve, e të cilat mund të bëjnë që një fëmijë të jetë në kundërshtim me ligjin, ose në rrezik për një gjë të tillë. Sidoqoftë, përmes këtij ligji adresohen shumë çështje të cilat ndërlidhen me aspektin e sjelljes dhe të cilat në mënyrë indirekte ndikojnë në parandalimin e sjelljeve në kundërshtim me normat e përcaktuara shoqërore.

Këtu përfshihen dispozitat që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e nxënësve në shkollë dhe parandalimin e braktisjes së shkollës¹⁶, pastaj promovimi i bashkëpunimit të shkollës me nxënës dhe prindër përmes formimit të këshillave të ndryshme si: Këshillit Drejtues të Shkollës (më tutje KD), si organi më i lartë drejtues i një shkolle¹⁷, Këshillit të Nxënësve¹⁸, dhe Këshillit të Prindërve¹⁹, organe këto të cilat kanë përgjegjësi të mbrojnë interesat e fëmijëve dhe prindërve në shkollë. Në vijim, në nenin 22 të LAP, parashihet që çdo shkollë duhet të ketë rregullat e saja të cilat i propozon KD i shkollës dhe aprovohen nga Komuna. Qëllimi i këtyre rregullave është promovimi i sjelljes së mirë për të promovuar konceptin e shkollave të shëndetshme dhe eliminimin e dhunës, por edhe të drejtat dhe detyrimet e nxënësve që nuk janë paraparë me këtë ligj²⁰. Por, ajo që bie në sy, si në UA, nr.06/2014 të MASHT, ashtu edhe në Rregulloret e Komunave për Kodin e Mirësjelljes dhe disiplinën e nxënësve, sikur edhe në rregullat që janë nxjerrë nga shkollat me aprovimin e komunave, një qasje të disiplinimit në shkolla përmes masave disiplinore të nxënësve në shkolla, në vend se kjo të bëhet përmes një qasje pro-sociale, përmes edukimit se si duhet të sillen në shkollë, familje, komunitet dhe në përgjithësi në shoqëri.

13 Policia e Kosovës, Procedurat Standarde të Operimit. Qasja Policore ndaj Rasteve me Persona të Mitur DDO – 04/041/2013, E(1.3), F(1.2) dhe F(1.3)

14 Policia e Kosovës, Procedurat Standarde të Operimit. Qasja Policore ndaj Rasteve me Persona të Mitur DDO – 04/041/2013, F(1)

15 Policia e Kosovës, Procedurat Standarde të Operimit. Qasja Policore ndaj Rasteve me Persona të Mitur DDO – 04/041/2013, E(1.1 dhe 1.2)

16 Ligji për Arsim Parauniversitar i Kosovës nr. 04/L-032, neni 15

17 Ligji për Arsim Parauniversitar i Kosovës nr. 04/L-032, neni 17

18 Ligji për Arsim Parauniversitar i Kosovës nr. 04/L-032, neni 18

19 Ligji për Arsim Parauniversitar i Kosovës nr. 04/L-032, neni 19

20 Ligji për Arsim Parauniversitar i Kosovës nr. 04/L-032, neni 22

Në lidhje me parandalimin e dukurive negative në shkolla dhe në shoqëri, LAP në nenin 23 jep mundësinë edhe për aktivitete jashtëshkollore dhe ekstra kurrikulare²¹. Gjithashtu ky ligj, duke iu referuar nenit 37.1 të LAP-it, komunat mund të punësojnë edhe shërbime profesionale në shkollë, përfshirë shërbimet që kanë të bëjnë me: kujdesin mjekësor, mbështetjen pedagogjike-psikologjike, si dhe punë këshilluese dhe sociale në shkollë, ku ndër detyrat dhe përgjegjësitë e këtij shërbimi janë puna me fëmijët me vështirësi në sjellje, prindër dhe mësime, në tejkalimin e këtyre vështirësive²². Një kriter i tillë, është shumë i lartë në kushtet e sotme të zhvillimit shoqëror nëpër të cilin po kalojmë si shoqëri. Por, ajo që është edhe më e rëndë, nga ajo që shihet në praktikë, kemi një numër simbolik të psikologëve dhe pedagogëve të punësuar në shkolla, që nënkupton se as sipas këtij kriteri ende s'kemi psikologë e pedagogë nëpër shkollat e Kosovës.

Gjithëpërfshirja në arsim dhe në shoqëri në përgjithësi, është një prej parimeve udhëheqëse në arsimin Parauniversitar, sipas të cilit institucionet arsimore dhe aftësuese duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe kontaktin mes vetë fëmijëve²³. Kjo gjë rregullohet në vijim me edhe UA nr.18/2013, për Përdorimin e Planit Individual të Arsimit, në bazë të së cilit, të drejtën për Plan Individual të Arsimit (më tutje PIA)²⁴ e ka fëmija i cili ka nevojë për mbështetje shtesë në edukim dhe arsim për shkak të vështirësisë në qasje dhe pjesëmarrje, si dhe kur këto vështirësi ndikojnë në arritjen e rezultateve të arsimit të përgjithshëm, sidomos edhe kur fëmija ka vështirësi në mësime për shkak të aftësisë së kufizuar specifike në të mësuar apo në sjellje dhe zhvillim emocional²⁴. Pra, kjo dispozitë mundëson nxënësve që kanë vështirësi të caktuara në sjellje dhe emocione, mund të përdoret PIA, si një qasje e veçantë arsimore në kuadër të arsimit të përgjithshëm gjithëpërfshirës, që do t'i ndihmonte atij në tejkalimin e vështirësive që ka.

Risi është hartimi i Rregullores QRK - Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e arsimit parauniversitar, e miratuar nga Qeveria në Qershor 2013. Ky Protokoll: përcakton detyrimet, qartëson rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin, raportimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe përforcon bashkëpunimin ndërinstitucional dhe multidisiplinar për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe për t'u mbrojtur fëmijët nga dhuna²⁵.

Nga legjislati në përgjithësi që u trajtua, shihet se ekzistojnë një varg dispozitash që mundësojnë trajtimin dhe mbrojtjen e fëmijëve pa përgjegjësi penale, që kanë kryer vepra penale, ose që janë në rrezik për një gjë të tillë. Gjithashtu, ekzistojnë dispozita ligjore të shumta që obligojnë institucionet e ndryshme të punojnë në parandalimin e sjelljeve të tilla të fëmijëve dhe në përgjithësi të dukurive negative që mund të afektojnë jetën e fëmijëve. Megjithatë, kuadri ligjor aktual, nuk përcakton shërbime të veçanta karakteristike për fëmijët që janë në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin apo fëmijët në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale, përpos atyre që në përgjithësi ofrohen për fëmijët që janë në nevojë për mbrojtje dhe shërbime sociale, sikur që edhe nuk bënë përgjegjës në mënyrë eksplicite ndonjë institucion për të punuar në parandalimin e kësaj dukurie.

21 Për më shumë shih, MASHT, UA, nr.16/2014, për aktivitete jashtëshkollore

22 Për më shumë shih, MASHT, UA, nr.26/2013, për Zgjedhjen e Nëpunësve për Ofrimin e Shërbimeve Profesionale në Institucionet Edukativo-arsimore Parauniversitare dhe MASHT, UA, nr.34/2014, për Funksionimin e Shërbimit Pedagogjik – Psikologjik në Shkollat

23 Ligji për Arsim Parauniversitar i Kosovës nr. 04/L-032, neni 40 (2.1)

24 MASHT, UA, nr.18/2013, për Përdorimin e Planit Individual të Arsimit, neni 3(20 dhe 3 (2.1)

25 Neni 1, Qëllimi dhe fushëveprimi i Protokollit



Kapitulli 2

Të gjeturat

2.1 Trendi

- Numri i fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale gjatë vitit 2014, të asistuar nga ana e QPS-ve, është 721 fëmijë, përdorisa numri i fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale gjatë vitit 2013, të asistuar nga ana e QPS-ve, ishte 599;
- Fëmijë që me sjelljen e tyre janë në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin gjatë vitit 2014, ishin 122 fëmijë, kurse gjatë vitit 2013, ishin 91. Raste të tilla janë të dukshme në shkollë, por edhe jashtë tyre. Por, ka një numër relativisht të vogël të këtyre rasteve të referuara në QPS, sidomos nga shkollat²⁶;
- DKA-të, nuk kanë statistika të rasteve kur fëmijët sillen në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes dhe Rregullat e përcaktuara të shkollës. Por, sipas DKA-ve trendi është në rritje, sidomos ato që kanë të bëjnë me dhunën në shkollë, dhunën ndërmjet moshatareve, bartja e armëve të ftohta në shkollë, ikje nga shkolla, dëmtimi i pronës së shkollave, etj. Kjo dëshmohet “nga një hulumtim që kemi bërë për nevoja të brendshme të DKA-s, është treguar se nuk e kemi situatën e mirë në këtë drejtim, sidomos në lidhje me sigurinë në shkollë”, tregon zyrtarja e intervistuar nga DKA – ja në Prishtinë;
- Policia e Kosovës nuk mban evidencë (regjistra) për fëmijët që janë në rrezik apo që kryejnë vepra penale kur janë nën moshën 14 vjeç, pasi kështu sanksionohet me KDM. Megjithatë, duke u referuar në PSO për qasjen policore me persona të mitur, theksohet se kjo dukuri është në rritje dhe mjaft shqetësuese²⁷.

2.2 Karakteristikat e fëmijëve

Raportet e çrregulluara në familje, dhuna në familje, divorcet në familje, familjet me njërin prind, por edhe mungesa e përkujdesit dhe shkathtësive prindërore, si dhe kushtet ekonomiko-sociale të familjeve shihen si faktorët kyç që qëndrojnë prapa fëmijëve në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin ose në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale. Megjithatë sipas QPS-ve nuk përjashtohen edhe rastet e fëmijëve që vinë nga familjet me status të mirë ekonomik dhe social.

Sjelljet më karakteristike të fëmijëve, të cilat referohen në QPS janë: dhuna mes moshatarëve, dhuna në shkollë, ikje nga shkolla, ikje nga shtëpia, braktisje e shkollës, vjedhje, bartja e armëve të ftohta, etj. Për këtë analizë intervistat janë realizuar me fëmijët që janë në rrezik apo në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale dhe prindërit e tyre, raste aktualisht të menaxhuara nga Qendrat për Punë Sociale. Për gjithë fëmijët e intervistuar për këtë analizë, karakteristikë e njëjtë është se vinë nga familje me raporte të çrregulluara, dhunë në familje, familje me njërin prind, apo mungesë e përkujdesit dhe shkathtësive prindërore, si dhe me kushte ekonomiko-sociale të vështira.

²⁶ QPS në Ferizaj ka ofruar statistika të plota për rastet e referuara në 3 vitet e fundit, të tjerat vetëm të pjesshme, kryesisht për vitin 2014

²⁷ Nga statistikat që kemi marrë nga Policia e Kosovës, përfshijnë vetëm ato të fëmijëve mbi moshën 14 vjeç ku shihet një trend në rritje në tri vitet e fundit edhe tek këta fëmijë

2.3 Terminologjia

Terminologjia nuk është e unifikuar, ka një dallim në përdorimin e terminologjisë nga institucionet. Institucionet si QPS, MPMS, si dhe Policia përdorin termat “Fëmijë kryrës të veprave penale pa përgjegjësi penale” dhe “Fëmijë me sjellje asociale”. Kurse, në fushën e arsimit (në shkolla, DKA, MASHT), filtret për “Fëmijë problematikë”, “Fëmijë me sjellje problematike”, “Fëmijë me vështirësi në sjellje”, “Fëmijë me çrregullime në sjellje”.

2.4 Parandalimi

Në përgjithësi mungojnë aktivitetet parandaluese. Ka iniciativa të caktuara, por edhe këto iniciativa janë të shkëputura dhe nuk përfshijnë të gjithë akterët në këtë fushë. Gjithashtu, nuk ka as programe të parandalimit, të planifikuara dhe të organizuara në mënyrë të përbashkët, duke përfshirë të gjitha institucionet përgjegjëse për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve.

Ka mungesë të organizimit të aktiviteteve parandaluese nga shkollat dhe DKA-të. Kryesisht shkollat dhe mësimdhënësit janë të përqendruar në aktivitete mësimore të bazuara në kurrikula të rregullta, por jo edhe në aktivitete edukative. Mungesa e orës së kujdestarisë (me pagesë) në kuadër të fondit të orëve, zvogëlon komunikimin në lidhje me problemet dhe dukuritë negative që i preokupojnë ata. Aktivitetet e lira dhe ato jashtëshkollore janë të përqendruara kryesisht në organizimin e ndonjë ngjarje apo feste të caktuar, apo edhe në organizimin e ndonjë mbrëmje dhe ekskursioni të caktuar, por jo edhe të aktiviteteve të tjera që mund të kenë për qëllim vetëdijesimin e nxënësve për dukuri të caktuara negative.

Policia organizon herë pas here aktivitete të ndryshme parandaluese, siç janë: ligjëratat në shkolla, fushata vetëdijesimi në media dhe komunitet, botimi i broshurave të ndryshme. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është informimi i fëmijëve dhe qytetarëve në përgjithësi për pasojat e dukurive të caktuara negative në shoqëri. Përpos bashkëpunimit me shkolla dhe me ndonjë OJQ, këto aktivitete nuk zhvillohen ndërlidhur dhe në bashkëpunim me institucione të tjera (QPS, etj).

Në përgjithësi, nuk ka strategji të planifikuara me aktivitete për parandalimin e kësaj dukurie. Në këtë drejtim, “për të mirë vlen të përmendet Komuna e Gjakovës dhe Prishtinës, të cilat kanë filluar hartimin e strategjive për siguri në shkolla, të cilat synojnë t’i përfshijnë të gjithë akterët relevant në fushën e mbrojtjes së fëmijëve”²⁸.

2.5 Identifikimi / Referimi

Shkolla nuk ka një mekanizëm të institucioneve, sidomos të shkollave për identifikim të hershëm të fëmijëve që janë në rrezik që me sjelljen e tyre të jenë në konflikt me ligjin. Zakonisht, këto raste identifikohen vetëm kur ndodh ndonjë thyerje e rregullave, në të cilat raste kujdestari i klasës është ai që duhet të inicioj rastin për trajtim të mëtutjeshëm. Kur shkolla ka psikolog, ai referohet për trajtim nga psikologu. Në këtë drejtim, edhe në rastet kur identifikohen disa fëmijë me vështirësi në sjellje dhe emocione, që janë në rrezik apo në konflikt me ligjin, “nuk përdoret Plani Individual i Arsimit, sepse PIA përdoret vetëm për fëmijët më nevojat të veçanta në arsim, jo edhe

²⁸ Syri i Vizionit, citat

për këta fëmijë”, kështu mendon zyrtari i arsimit në Ferizaj, ani pse për shkak të sjelljeve të caktuara fëmijët në të shumtën e rasteve kanë edhe nevoja të veçanta arsimore.

Shkollat kanë tendencë t’i mbyllin rastet brenda tyre dhe të mos i referojnë më tutje në DKA, Polici dhe QPS, pa iu ofruar ndonjë trajtim dhe shërbim të veçantë. “Kjo ndodh sepse drejtorët dhe shkollat frikësohen se mos po akuzohen që nuk janë të suksesshme në punë dhe po prishin imazhin e tyre”²⁹. Vetëm në rastet me të rënda, që i tejkalojnë kufijtë e shkollës (shpesh raste me fatalitet), zakonisht rastet lajmërohen në DKA, Polici dhe institucione, siç është QPS-ja.

Policia është institucioni i cili i referon shumicën e rasteve në QPS. Rastet referohen edhe nga shkollat, megjithëse karshi problemeve të dukshme në shkolla, numri i rasteve të referuara nga shkollat është i vogël. Referimi nga shkollat është i theksuar më shumë aty ku veprojnë grupe punuese ndërinstucionale (Tryeza për Menaxhimin e Rasteve) të mbështetura nga Terre des hommes dhe gjithashtu referimi është më i theksuar nga shkollat e qytetit se sa të fshatit. Në rastet kur fëmijët kanë kryer vepër penale, referimi bëhet edhe nga Prokuroria. Numri i rasteve të referuara nga institucione tjera (psh. shëndetësore), si dhe nga prindërit e komunitetit është simbolik, edhe pse mundësinë e referimit e kanë të gjithë.

Kuadri ligjor ekzistues merret më shumë me procedurat dhe shërbimet që QPS mund të ofroj kur të ndodh rasti, në bazë të referimeve që mund të bëjnë institucionet e tjera. “Ka një bashkëpunim, por kjo është pasi të ndodh rasti, por jo edhe para se të ndodh rasti”, shprehet njëri nga punëtorët social të intervistuar³⁰. Përveç kësaj, ekziston bindja në të shumtën e rasteve se institucionet e tjera (sidomos shkollat, përjashtim bënë Policia), por edhe prindërit dhe komuniteti në përgjithësi nuk janë në dijeni për mundësinë e referimit të rasteve të fëmijëve në rrezik apo në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale në QPS.

2.6 Shërbimet aktuale

Kuadri ligjor aktual mundëson institucionet arsimore dhe QPS-në që të merren me rastet e fëmijëve që me sjelljen e tyre janë në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin.

Kodet e Mirësjelljes dhe Rregulloret e brendshme që kanë nxjerrë shkollat, janë dokumentet kryesore në bazë të së cilave trajtohen nxënësit kur thyejnë rregullat e shkollës dhe nuk veprojnë komform Kodit të Mirësjelljes. Por, “në të shumtën e rasteve rregullat të cilat i kanë bërë shkollat nuk respektohen”³¹. Andaj edhe për këtë ka tendencë që komunat të nxjerrin Rregullore unike që do të vlejnjë për të gjitha shkollat e asaj komune. Në përgjithësi, qasja e këtyre rregulloreve është në drejtim të përdorimit të masave disiplinore kur nxënësit thyejnë rregullat e shkollës, të cilat masa disiplinore nuk zbatohen³².

Shumica e mekanizmave të krijuar në shkolla (Këshilli Drejtues, Këshilli i Nxënësve, Këshilli i Prindërve), në shumicën e shkollave nuk janë funksionale. Kjo vlen edhe për Kodet e Mirësjelljes dhe Rregulloreve të brendshme të shkollave, të cilat ose nuk ekzistojnë, ose kur ekzistojnë, nuk janë të zbatueshme. Ato më shumë ekzistojnë për çështje formale. Kjo është edhe për shkak të mungesës së monitorimit të punës së këtyre organeve nga nivelet më të larta.

²⁹ DKA në Prishtinë, citat

³⁰ QPS në Prishtinë, citat

³¹ DKA në Pejë, citat

³² DKA në Prishtinë, citat

2.6.1 Mungesa e shërbimeve të veçanta

Kuadri ligjor përcakton moshën 14 vjeç si moshë të përgjegjësive penale. Ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale nuk zhvillohet procedurë gjyqësore, ose ndërpritet kur ajo fillon. Kjo gjë, përjashton procedurat e organeve të drejtësisë dhe ato të rendit, për këta fëmijë. QPS është institucion përgjegjës për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve në rrezik apo në konflikt me ligjin, pa përgjegjësi penale, mbrojtjen dhe trajtimin e tyre duhet ta bëjë në bashkëpunim të ngushtë me institucione qeveritare dhe jo-qeveritare.

Kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton shërbime të veçanta karakteristike, përpos atyre që në përgjithësi ofrohen për kategori të ndryshme që janë në nevojë sociale, sikur që edhe nuk bënë përgjegjës ndonjë institucion për të punuar në parandalimin e kësaj dukurie.

2.6.2 Këshillimi individual dhe ai familjar

Shërbimet kryesore sociale dhe familjare që iu ofrohen fëmijëve në rrezik apo në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale, të referuar në QPS janë këshillimi individual dhe ai familjar. Një shërbim i ngjashëm ofrohet edhe nga shkollat, ato të cilat kanë psikologë brenda tyre. Gjithashtu, fëmijëve, u mundësohet kthimi në shkollë kur ata pranojnë, në rastin kur ekipi për mbrojtje i formuar në kuadër të QPS, ose edhe menaxheri rastit e sheh të nevojshme, pas vlerësimit të rastit, propozon edhe dhënien e Asistencës Sociale ose edhe largimin e fëmijës nga shtëpia dhe vendosjen e tij në strehimore, referimin për trajtim në një institucion tjetër (shëndetësor apo te Psikologu i shkollës, etj). Përveç kësaj, ka raste kur shërbimet i lidhin me ndonjë donatorë (OJQ), duke i ofruar kurse të ndryshme (gjuhë të huaja).

Por, edhe këshillimi si shërbimi kryesor që kanë marrë fëmijët në rrezik apo në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale dhe familjet e tyre, ka qenë kryesisht i orientuar në atë se çfarë duhet të bëjë dhe çfarë nuk duhet të bëjë, se si duhet të sillen prindërit ndaj fëmijës dhe si nuk duhet të sillen. “Zakonisht na tregojnë se qysh duhet të sillemi, i thojnë qikës mos e bon ata, mos e bon këta, kështu...”, tregon prindi i një fëmije të intervistuar³³. Si i tillë një këshillim i tillë është i pamjaftueshëm dhe jo adekuat.

2.6.3 Programet për ri-integrim

Fëmijët e intervistuar deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë në ndonjë program rehabilitues apo ri-integrues, pasi që edhe nuk u është ofruar një gjë e tillë. Ka raste kur janë referuar në trajtim tek ndonjë psikolog në ndonjë institucion tjetër, njëri nga t’atë është strehuar në strehimore (por ka ikur nga ajo), pastaj janë referuar edhe në Qendra të Kujdesit Ditor, ose edhe ndonjë kurs në bashkëpunim me ndonjë OJQ.

Disa nga fëmijët e intervistuar kanë pasur edhe kërkesa të caktuara në drejtim të punëtorëve social, bie fjala largimi nga familja për shkak të dhunës që përjetojnë dhe dërgimi në ndonjë strehimore, gjë e cila nuk iu është plotësuar. Ka të tillë që kanë dëshiruar ndonjë kurs (në muzikë, kurse aktrimi, në gjuhë të huaj), por nuk iu janë realizuar. “Mua më pëlqen muzika, sidomos repi dhe kisha dashtë të shkoj në ndonjë kurs të muzikës. Kam kërkuar nga QPS, por s’kanë kurse të tilla”³⁴.

³³ Prindi i intervistuar në Ferizaj, citat

³⁴ Fëmija i intervistuar në Pejë, citat

Megjithatë, fëmijët dhe prindërit e tyre në përgjithësi e konsiderojnë të dobishme referimin e tyre në QPS, sepse mendojnë se puna e punëtorëve social ka ndikuar pozitivisht në jetën e tyre, së paku për një kohë të caktuar. Edhe pse, në fillim nuk e kanë pritur mirë referimin dhe kanë hezitur, ata tani nuk kanë ndonjë vështirësi, sepse janë trajtuar mirë dhe me respekt.

Gjithashtu, ka edhe raste kur fëmijët e intervistuar theksojnë se kur nuk iu kanë përmbajtur këshillave, ata janë kërcënuar nga punëtorët social, që “nëse vazhdon kështu, do të shkosh në burg”³⁵. E njëjta gjë vlen edhe për shkollat, përkatësisht për psikologun e shkollës dhe drejtorët e shkollave, që i kanë kërcënuar se do t’i përjashtojnë nga shkolla. “Ke shumë mungesa dhe nuk po ndalesh hiç. Për këtë ne duhet të të përjashtojmë, s’na mbetet tjetër”, rrëfen njëri nga fëmijët e intervistuar³⁶.

Ka raste kur fëmijët janë etiketuar qoftë nga mësimdhënësit, qoftë nga moshatarët e tyre për sjelljen e tyre ose nacionalitetin e tyre, gjë e cila shpesh i ka penguar ata në procesin e ri-integrimit të tyre në shoqëri. “Në shkollë më quajnë rom dhe më akuzojnë se kam thyer një karrige, unë karrigen nuk e kam thyer...”, shprehet njëri nga fëmijët e intervistuar³⁷.

2.6.4 Trajtimi nga organet e drejtësisë dhe rendit

Shërbimet që ofrohen për fëmijët janë të pamjaftueshme. Andaj edhe si rezultat i mungesës së shërbimeve është se “këta fëmijë kur kalojnë moshën e përgjegjësisë penale, ata po vazhdojnë me të vjetrën”, tregon një zyrtarë e intervistuar nga QPS³⁸. Kur kësaj t’i shtojmë edhe mungesën e një fondi emergjent, mungesën e programeve për ri-integrimin e tyre, si dhe bashkëpunimin në nivel të ulët të prindërve, atëherë del se këto shërbime janë të pamjaftueshme për fëmijët, andaj edhe shpesh mungojnë rezultatet në punë. Për këtë, rastet shpesh përsëriten, ato mbesin të hapura për kohë të gjatë dhe në fund këta fëmijë kalojnë moshën e përgjegjësisë penale (14 vjeç), bëjnë vepra të reja penale dhe fillojnë përsëri të trajtohen, por tani nga organet e drejtësisë dhe rendit.

Nga fëmijët e intervistuar, dy nga pesë prej tyre deri diku janë ri-integruar në jetën e përditshme, megjithëse ende janë në rrezik pasi ende vërehen shenja jo stabiliteti. Kurse, për tre të tjerët shërbimet e ofruara nga QPS dhe institucionet tjera nuk kanë mjaftuar dhe nuk kanë qenë të sukseshme, për ri-integrimin e tyre.

2.7 Sfidat për menaxhimin e rasteve

QPS-të, shkollat dhe institucionet në përgjithësi kanë mungesë kapacitetesh profesionale për të trajtuar fëmijët në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin dhe fëmijët në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale. Zyrtarët e shërbimeve sociale dhe familjare të intervistuar, shpesh e shohin veten të papërgatitur për të punuar me rastet e fëmijëve. “Ne gjatë këtij viti kishim punën më mirë me psikologë dhe kjo për ne ishte ndihmë e madhe, sepse puna me këta fëmijë kërkon kuadro të specializuar”, janë fjalët e një zyrtari të shërbimeve sociale të intervistuar në Prishtinë. Kjo

³⁵ Fëmija i intervistuar në Pejë, citat

³⁶ Fëmija i intervistuar në Ferizaj, citat

³⁷ Fëmija i intervistuar në Prizren, citat

³⁸ QPS në Ferizaj, citat

tregon se QPS-të nuk kanë staf të profilizuar, nuk kanë psikologë dhe punëtorë social të profilizuar, për punë me këta fëmijë.

Shkollat nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të menaxhuar nxënësit që janë në rrezik apo në konflikt me ligjin. Kjo ka të bëjë në radhë të parë me mungesë të kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve dhe të personelit tjetër për të menaxhuar me ta, mungesa e psikologëve dhe pedagogëve në shkolla, bashkëpunimi jo në nivel me prindërit dhe mungesa e përgjegjësive së tyre karshi fëmijëve, hapësirë e pamjaftueshme në shkolla (puna me tri ndërrime), mungesa e hapësirave për organizimin e aktiviteteve të lira jashtë mësim, etj.

Përveç kësaj, mungojnë edhe institucionet e tjera për trajtimin e fëmijëve (Institucione të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë), pastaj institucione ku fëmijët do të vendoseshin për trajtim më të gjatë, ose edhe qëndrim ditor, etj. Sikur që, mungojnë edhe profesionistë nëpër institucione të ndryshme, kryesisht psikologë dhe punëtorë social, psh, në Qendra të Mjekësisë Familjare, Polici, por edhe në Gjykata dhe Prokurori.

2.8 Bashkëpunimi

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve për menaxhimin e rasteve fëmijëve në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin apo fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale, nuk është në nivel të duhur. Ka një reagim të tyre kur rasti ndodh, sidomos kur ai tejkalon përmasat e një institucioni (raste më të rënda), referohen prej një institucioni në tjetrin (zakonisht Shkollë – Polici – QPS). Por, mungon lidhja e shërbimeve mes institucioneve dhe llogaridhënia për vazhdimësinë e trajtimit të rastit. Gjithashtu, bashkëpunimi, komunikimi dhe llogaridhënia është në nivel të ulët edhe kur kemi të bëjmë me aktivitete që kanë qëllim parandalimin. Kjo bënë që shpesh institucionet që kanë për mandat mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal nuk njohin ose nuk janë të familjarizuara me legjislacionin nga fushat e tjera e shpesh edhe në fushën përkatëse, që rregullon fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Bashkëpunimi i QPS-ve me akterët kryesorë përgjegjës për mbrojtjen fëmijëve në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin apo fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale për menaxhimin e rasteve të tilla është në nivel jo të mjaftueshëm. Ky bashkëpunim është më i mirë në rastet kur ndodhë vepra penale ose sjellja e caktuar nga ana e një fëmije apo grupi fëmijësh. Por, nuk ka koordinim dhe bashkëpunim të QPS me institucione tjera në parandalimin e problemeve dhe dukurive negative që po shfaqen në shoqëri dhe as në procesin e ri-integrimit të fëmijëve. Bashkëpunimi është më i shprehur në ato vende ku janë krijuar grupet punuese (Treyzat për Menaxhimin e Rasteve) që mbledhin këto institucione, të cilat janë mundësi për të referuar dhe trajtuar raste në grup për ofrimin e shërbimeve³⁹.

Bashkëpunimi i Policisë me institucionet si QPS, Shkolla, DKA dhe OJQ, në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin apo fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale është në nivel. Por, kjo nuk mund të thuhet për bashkëpunimin me prindër dhe komunitetin në përgjithësi, për çka “Ne kemi shumë vështirësi për të identifikuar dhe për të kuptuar moshën e fëmijëve, prindërit nuk i gjejmë ose nuk na përgjigjen”⁴⁰, tregon njëri nga zyrtarët policor të intervistuar. Përveç kësaj Policia ftohet zakonisht kur ndodh ndonjë problem, por janë shumë të rralla rastet kur Policia ftohet në shkollë ose në ndonjë institucion tjetër (pos nga ndonjë OJQ), për ndonjë ligjërata ose bisedë për një temë të caktuar me fëmijët dhe prindërit⁴¹.

³⁹ QPS në Prishtinë, citat

⁴⁰ Policia në Pejë, citat

⁴¹ Policia në Ferizaj, citat

Bashkëpunimi i shkollave dhe DKA-së me institucione tjera (QPS, Polici, OJQ), për menaxhimin e rasteve që kanë të bëjnë me fëmijë në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin apo fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale. Ky bashkëpunim vjen në shprehje vetëm atëherë kur ftohen këto institucione, apo kur referohen raste tek to ose përmes Tryezës për Menaxhimin e Rasteve. Ky bashkëpunim nuk është në nivel as me prindërit. “Shpesh mungon një mekanizëm që kushtëzon prindërit të dorëzojnë kontaktet e tyre në shkolla, sepse nxënësit që bëjnë probleme zakonisht i fshehin këto kontakte”⁴².

2.9 Raste studimi

Rast studimi 1

Ajo është vetëm 13 vjeç dhe vijon mësimin në klasën e tetë në Pejë. Jeton me dy axhallarët e saj, pasi babai i saj migroi në Francë derisa e ëma ka kohë që është e divorcuar nga i ati dhe martuar me dikë tjetër. Përsëritje të dhunës ndaj bashkëmoshatarëve, ngacmim, marrje parash, dëmtim të pronës në shkollë, ikje nga shkolla, ikje nga shtëpia, bredhje rrugësh, etj, janë vetëm disa nga veprimet për të cilat kjo vajzë, e cila është pjesë e një “grupi” fëmijësh nga Peja. Rasti i saj u referua nga policia pas problemeve të vazhdueshme. Dy axhallarët e saj, ndërkaq dyshohet se ushtrojnë dhunë të vazhdueshme ndaj saj.

Për këtë, vetë vajza thotë se i ka njoftuar edhe zyrtarët e QPS-së në Pejë, duke iu kërkuar ta largojnë nga shtëpia e axhallarëve dhe ta dërgojnë në strehimore, ngase dhuna ndaj saj nuk ka të ndalur “unë kam kërkuar prej tyre (zyrtarët e QPS), që të më largojnë nga shtëpia dhe të më dërgojnë në strehimore sepse unë kam dhunë në familje prej tyre prej mëngjesit deri në mbrëmje. Veç në shkollë largohem prej kësaj, por zyrtarët e QPS për të më dërguar në strehimore kanë kërkuar që të denoncojë axhallarët e mi, por unë këtë nuk mund t’a bëjë sepse ata janë të vetmit të cilët janë kujdesur për mua dhe më kanë rritur, nuk mundem....”, rrëfen ajo për KOMF.

Ajo thotë se në QPS i pëlqen të shkojë ngase i kanë ndihmuar të kthehet pikërisht në vendin ku nuk ka dhunë ndaj saj, në shkollë. Ndihmën më të madhe thotë se e mori nga kujdestari i saj i klasës, i cili e ka përzgjedhur kryetare të klasës. Kjo e bënë të ndihet krenare dhe thotë se me zell përkujdeset që të ketë rend në klasë dhe gjithçka të shkojë mirë. Si një fëmijë që thotë se e di se çka do të thotë të kesh nevoja të cilat të mungojnë, ajo ka dëshirën e madhe t’iu ndihmojë fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollën e saj.

“Qysh si fëmijë kur isha në çerdhe kam menduar se për çfarë arsye edukatorja u afrohet me shume disa fëmijëve dhe kam kuptuar se kjo është pasi mu me mungon dashuria e nënës. Tash e di se fëmijëve me nevoja të veçanta iu mungon diçka (këmbë, sy, vesh, etj), e mua me mungon dashuria e nënës, pra secilit prej neve i mungon diçka, për këta kisha dashtë shumë me iu ndihmu atyre”, thotë ajo.

Këtë dëshirë vajza 13 vjeçare nga Peja thotë se dëshiron t’ia bëjë me dije edhe drejtorit të shkollës, por tregon se nuk ka marrë vëmendjen e duhur asnjëherë andaj frikësohet t’i propozojë një gjë të tillë.

Krejt çka dëshiron kjo vajzë është që të mos e trajtojnë me dhunë dhe forma të tjera të këqija. “Unë jam mësu me të keqe, veç me të mirë munden me m’ndihmu ndryshe hiç”, përfundon ajo rrëfimin e saj për KOMF.

⁴² DKA në Prizren, citat

Rast studimi 2

Ka më tepër se 4 javë që nuk gëzon të drejtën që të jetë në mesin e shoqeve dhe shokëve të klasës së tij. N. nga Prizreni, i është marrë kjo e drejtë, qysh në klasën e 7, për një periudhë të caktuar, ngase 14 vjeçari akuzohet të ketë bërë dëmtrim të bazës materiale në ambientet e shkollës.

E kjo, nuk është barra e vetme, e cila rëndon 14 vjeçarin. Ky i ri nuk e ka më as dëshirën që të kthehet në shkollë. Atje, thotë se ndihet i diskriminuar dhe i turpëruar. "Në shkollë më quajnë romë dhe më akuzojnë se kam thyer një karrige, unë karrigen nuk e kam thyer", u shpreh me indinjatë N.

Lënda e tij, për dëmtrim të bazës materiale në shkollë, me referim të Prokurorisë tashmë gjendet në Gjykatë. Derisa, familja e tij, me gjendje mesatare ekonomike, përkrahjen e vetme nga aspekti social thotë se e ka gjetur në Qendrën për Punë Sociale, në Prizren. Problemet e N me shkollën kishin filluar qysh vitin e kaluar. QPS-ja, kishte ndërhyrë në shkollë duke diskutuar gjendjen e djalit me drejtoreshën e atëhershme si dhe mësuesen kujdestare të N, qysh në vitin e parë kur janë shfaqur problemet, me qëllim të krijimit të një ambienti më mikpritës për djalin dhe me qëllim të zgjimit të dëshirës së tij për t'u kthyer në mësim.

Por, problemi kryesor doli të jetë fakti se fëmia është stereotipizuar si kategori e komunitetit romë. Edhe pas përpjekjeve të shumta të QPS-së dhe familjes së djalit, marrëdhëniet e tij me shkollën janë prishur përsëri këtë vit pasi që drejtori i ri, në sy të djalit, kishte turpëruar babain e tij. Madje, që atëherë N. i janë shfaqur edhe shenjat e para të belbëzimit.

Fëmijës nuk i është ofruar asnjë shërbim akoma, pasi deri në fillim të këtij viti i është bërë e mundur që të shkojë në shkollë. Ndërkohë propozimi i radhës nga QPS-ja është që ai t'i bashkohet aktiviteteve ditore të Qendrës së Kujdesit për Fëmijë me degën në Prizren – Pema. Vitin e kaluar ndërkaq, me kërkesë të Prokurorisë, djali është përfshirë në një terapi grupi ku është bërë pjesë e një tubimi për mbrojtjen e fëmijëve me sjellje asociale.

Vetë N. thotë se qetësinë e gjen në QPS, ku bisedon më lirshëm ngase atje e kuptojnë se jo gjithherë ai ka qenë fajtor. Atje, madje thotë se i kanë ndihmuar shpesh herë për të rregulluar marrëdhëniet në shkollë dhe shtëpi.

Por thotë se dëshirat e tij më të mëdha janë që të shëtisë më shumë, të ketë shoqëri dhe të mos paragjykohej. Derisa shprehet i dëshpëruar me ambientin që i është ofruar në Kosovë. "Nuk do ta dua mësuesen kurrë dhe nuk dua të shkojë në shkollë", janë vetëm disa nga mohimet që shpreh.

Derisa me mallëngjim kujton se disa herë ka marrë notën pesë në shkollë, tani pasi është bërë një kohë që nuk ka qenë në shkollë ndihet i turpëruar të vazhdojë. "Kur të rritem do të iki nga Kosova dhe do të shkojë në Gjermani", është dëshira e fundit që fëmia shpreh para KOMF dhe Qendrës për Punë Sociale.

Përfundim

Trendi i rasteve të fëmijëve në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin dhe fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale, është në rritje. Kjo dukuri është sidomos e dukshme në shkolla, por edhe jashtë tyre.

Për rastet e referuara në QPS dhe në përgjithësi për fëmijët që janë në rrezik ose në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale, nuk ka shërbime të veçanta që iu ofrohen atyre. Kjo bënë që shërbimet aktuale të jenë të pamjaftueshme dhe ndikimi i tyre të jetë i vogël në parandalimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin e fëmijëve.

Kjo situatë kërkon domosdoshmërisht që të ketë shërbime të reja, qëllimi kryesor i të cilave do të ishte parandalimi, mbrojtja dhe ri-integrimi i fëmijëve që janë në rrezik ose atyre që janë në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale.

Në këtë drejtim është shumë me rëndësi, fuqizimi i QPS si organ përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, në mënyrë që të ofrojnë shërbime cilësore në përgjithësi dhe për fëmijët në veçanti. Gjithashtu, është me rëndësi të veçantë fuqizimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla, si dhe i mekanizmave tjerë të paraparë me ligj në kuadër të shkollave (Këshillit Drejtues, Këshillit të Nxënësve dhe Këshillit të Prindërve). Qëllimi kryesor i funksionimit të tyre është promovimi i bashkëpunimit të shkollës me nxënësit, prindërit dhe komunitetin, si dhe i vendimmarrjes së përbashkët.

Krijimi i shërbimeve të reja, fuqizimi i institucioneve dhe rritja e bashkëpunimit mes institucioneve, bëjnë të mundur që në të ardhmen të zvogëlohet numri i fëmijëve që do të jenë në konflikt me ligjin edhe pas moshës 14 vjeç, përkatësisht të zvogëlohet recidivizmi dhe krimi në përgjithësi në shoqëri.

Institucionet duhet të investojnë në infrastrukturen argëtuese, sport, aktivitetet kulturore, psiko-edukative përkrah atyre shkollore.

Investimi në këtë moshë, përkatësisht në parandalim, në aspektin afatgjatë, shtetit do t'i kushtoj më lirë se sa investimi në moshat më të rritura.



Kapitulli 3

Rekomandime

Rekomandime të përgjithshme

- Eshtë më se e nevojshme përcaktimi i një terminologjie të unifikuar bazuar në terminologjinë e cila përcaktohet sipas kriterëve dhe standardeve ndërkombëtare. Institucionet si QPS, MPMS, si dhe Policia përdorin termat “Fëmijë kryrës të veprave penale pa përgjegjësi penale” dhe “Fëmijë me sjellje asociale”. Kurse, në fushën e arsimit (në shkolla, DKA, MASHT), përmendën terme si: “Fëmijë problematikë”, “Fëmijë me sjellje problematike”, “Fëmijë me vështirësi në sjellje”, “Fëmijë me çrregullime në sjellje”;
 - Të bëhen ndryshime në kuadrin ligjor në lëmin e shërbimeve sociale, të cilat do të mundësonin që fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale, t’iu ofrohen shërbime mbrojtëse psiko-sociale, që mund të jenë: masa edukuese, masa shëndetësore (shëndetit mendor), sociale, këshillimi psikologjik, të mbikëqyrjes, programe për ri-integrim dhe shërbime të tjera mbrojtëse;
 - Legjislacioni të parashohë shqiptimin e masave edhe për prindërit e fëmijëve që janë në rrezik apo në konflikt me ligjin, në rastet kur ata nuk ushtrojnë siç duhet përgjegjësitë prindërore karshi fëmijëve;
 - Formimi i një Mekanizmi Koordinues në nivel lokal (në të duhet të shkrihen të gjitha mekanizmat ekzistues që po krijojnë dualizëm), që do të përbëhej nga institucionet që kanë për mandat mbrojtjen e fëmijëve. Ky mekanizëm do të nxiste komunikimin mes institucioneve (QPS, Shkolla, Policia etj), referimin dhe koordinimin e aktiviteteve në mbrojtjen e fëmijëve, si dhe një llogaridhënie më të mirë për detyrat dhe përgjegjësitë që kanë në këtë fushë;
 - Fëmijët që janë në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin, kanë potencial të cilin mjedisi nuk ia ofron që ta shprehin, ndaj, investimi në sport, kulturë, art është kurimi afatgjatë dhe më premtues i një shoqërie. Komunitat duhet te promovojnë dhe investojnë në programe për ri-integrimin e tyre;
 - Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive të përbashkëta për të gjitha institucionet që kanë mandat mbrojtjen e fëmijëve, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe që institucionet të njohin më mirë punën e njëri tjetrit, legjislacionin në tërësi për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve;
 - Krijimi i një Strategjie ndërinstitucionale për parandalim. Në kuadër të kësaj strategjie të hartohen edhe programe vetëdijesimi, pastaj programe për identifikim të hershëm të fëmijëve që mund të jenë në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin, si dhe programe intervenuese përmes të cilëve do të bëhej përpjekje që të edukohen dhe trajtohen ata që veç kanë kryer shkelje dhe janë në konflikt me ligjin, në mënyrë që të mos përsërisin sjelljen e tyre dhe të ri-integrohen në shoqëri. Këto programe të çertifikohen dhe të futen edhe në Kurrikulat mësimore në kuadër të arsimit parauniversitar.
-

Rekomandime për MASHT dhe DKA

- Shkollat të përqendrohen në identifikimin e hershëm të fëmijëve që janë në rrezik për të shfaqur sjellje në kundërshtim me normat dhe rregullat e përcaktuara. Në këtë drejtim, ngritja e kapaciteteve të shërbimit pedagogjik-psikologjik për vlerësimin e fëmijëve është e domosdoshme. Punësimi i psikologëve, pedagogëve apo punëtorëve social nga komunat është një nevojë e kohës;
- Fuqizimi i mekanizmave të ndryshëm brenda shkollës, që promovojnë vendimmarrjen dhe bashkëpunimin e shkollës me nxënës, prindër dhe komunitetin, siç janë: Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli i Prindërve dhe Këshilli i Nxënësve. Përmes këtyre mekanizmave të hartohen dhe të mbikëqyret zbatimi i Kodit të Mirësjelljes dhe Rregulloreve të brendshme të shkollës, të cilave në radhë të parë duhet të promovojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, gjithëpërfshirjen në arsim, si dhe forma të edukimit alternativ për fëmijët që sillen në kundërshtim me këto rregulla. Në këtë, futja e ndërmjetësimit në shkolla ndërmjet vetë nxënësve (bashkëmoshatarë), është një mënyrë e mirë për zgjidhjen e konflikteve në shkollë;
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të shkollave, përmes trajnimit të mësimdhënësve dhe stafit tjetër të shkollave për të menaxhuar me sjelljet e "vështira" të fëmijëve;
- Zbatimi i Rregullores QRK - Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e arsimit parauniversitar.

Rekomandime për MPMS dhe DKSHMS

- Fuqizimi i QPS-së përmes profilizimit të stafit për të punuar me fëmijët në përgjithësi, përfshirë fëmijët në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale dhe fëmijët në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin;
- Të hartohen programe të veçanta për ri-integrimin e fëmijëve që janë në rrezik apo në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale. Këto programe, duhet të jenë me qasje sistemore, që nënkupton se duhet të jenë gjithëpërfshirëse, në kuptim e lidhjes së shërbimeve, të përfshirjes së prindërve, komunitetit dhe të gjitha institucioneve relevante që merren me mbrojtjen e fëmijëve;
- Brenda QPS-ve të krijohen ekipe multidisiplinare që do të trajtonin fëmijët nga këndvështrime të ndryshme dhe me një qasje multidisiplinale: psikolog, punëtor social, pedagog, jurist, etj. Komunitat të punësojnë psikologë brenda QPS-ve;
- Komunitat të kontraktojnë ato OJQ përmes blerjes së shërbimeve, të cilat ofrojnë programe të veçanta dhe shërbime të specializuara për parandalimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin e fëmijëve që janë në rrezik apo në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale;



- MPMS duhet të hartojë planin vjetor të trajnimeve për QPS-të bazuar në standardet minimale të shërbimeve sociale. Ngritja e kapaciteteve profesionale për stafin e QPS-së përmes trajnimeve për ofrimin e shërbimeve për fëmijë është e domosdoshme;
- Të promovohet brenda institucioneve dhe komunitetit në përgjithësi, roli i Qendrave për Punë Sociale dhe puna që bënë ky institucion në parandalimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin e fëmijëve që janë në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin apo që janë në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale.

Rekomandime për Policinë

- Punësimi i psikologëve dhe punëtorëve social në Polici është i domosdoshëm për të krijuar një ambient miqësor, për të evituar stresin që mund t'a kenë fëmijët në konflikt me ligjin apo ata në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin në momentin kur janë në kontakt me Policinë;
 - Të fuqizohet bashkëpunimi me QPS. QPS është institucion me mandat të plotë për rastet në nevojë për mbrojtje dhe shërbime sociale, përfshirë fëmijët në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale, ndaj asnjë veprim nuk duhet të ndërmerret pa bashkëpunimin e plotë me QPS.
-

Literatura e shfrytëzuar

- Kodi Penal;
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur, nr. 03/L-193;
- Ligji për Familje, nr.2004/32;
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, nr.02/L-32;
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare i ndryshuar, nr.04/L-081;
- Ligji për Arsim Parauniversitar, nr. 04/L-032;
- Ligji i Policisë, nr.04/L-076;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit);
- MPMS, UA.nr.08/2013, për Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale pa Përgjegjësi Penale dhe të atyre me Sjellje Asociale;
- MASHT, UA, nr.16/2014, për Aktivitete jashtëshkollore;
- MASHT, UA, nr.34/2014, për Funksionimin e Shërbimit Pedagogjik – Psikologjik në Shkolla;
- MASHT, UA, nr.26/2013, për Zgjedhjen e Nëpunësve për Ofrimin e Shërbimeve Profesionale në Institucionet Edukativo-arsimore Parauniversitare;
- MASHT, UA, nr.18/2013, për Përdorimin e Planit Individual të Arsimit;
- Standardet Minimale për Shërbime Sociale;
- Policia e Kosovës. Procedurat Standarde të Operimit. Qasja Policore ndaj Rasteve me Persona të Mitur DDO – 04/041/2013;
- Rregullore për Disiplinën dhe Mirësjelljen në Shkollat e Komunës së Lipjanit, nr.116-724.



KOMF:

16 organizata jo-qeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë, me qëllim të koordinimit të mëtejshëm të përpjekjeve të tyre në mbrojtjen e fëmijëve, me mision mbrojtjen, respektimin dhe avancimin e mirëqenies dhe të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Organizatat anëtare janë: Associazione Amici dei Bambini, Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim - ASTRA, Iniciativa 6, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore MVPT, One to One Children's Fund, One To One Kosova - Qendra e Këshillimit për Familje, Organizata Rinore Akti, Save the Children, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë, Terre des hommes, World Vision, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, OPFAKKOS, Qendra për Arsim e Kosovës - KEC, Programi për të Drejtat Civile dhe VoRAE.



Projekti "Kush flet për Mua?",
mbështetet nga
Zyra e UNICEF-it në Kosovë



mario

KOMF mbështetet
nga projekti Mario



Save the Children